VENDIM
Nr. 46, datë 16.6.2014

PËR AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË

Në mbështetje të neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe të pikës 4 të nenit 7 të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisonerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.6.2014, pasi shqyrtoi kërkesën e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, dërguar me shkresën nr. 3704, datë 13.6.2014, "Mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë CEZ a.s.",

VENDOSI:

1. Autorizohet z. Petrit Ahmeti, kryetar i Entit Rregullator të Energjisë, që të marrë pjesë në procesin e finalizimit të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë CEZ a.s.
2. Në rast të arritjes së një marrëveshjeje, autorizohet z. Ahmeti, që të nënshkruajë marrëveshjen dhe çdo instrument që i bashkëlidhet asaj, në emër të Entit Rregullator të Energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti